



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURIYETI

C.nr.630/15

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Valon Totaj, me procesmbajtësen Drita Qerreti, në kontestin e paditësit D. H. nga Prishtina, rruga ... nr..., të cilin e përfaqëson av.B. J. nga Prishtina, kundër të paditurës KAG-Asphalt Company Sh.P.K K. e V. komuna e Prizrenit, e përfaqësuar nga të autorizuarit M. F. dhe av.R. H. nga Prizreni, për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor, me datën 25.08.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit D. H. nga Prishtina, andaj **DETYROHET** e paditura KAG - Asphalt Company, Sh.P.K. K. e V. komuna e Prizrenit, që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, t'ia paguaj paditësit shumat si në vijim:

- në emër të dhimbjeve fizike të përjetuara, shumën prej 5000 euro;
- për frikë, shumën prej 3000 euro;
- për shëmtim, shumën prej 1500 euro;
- për dhimbje shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë 5 %, shumën prej 2500 euro;
- për ndihmën e personit të tretë në kohëzgjatje prej një viti, shumën prej 150 euro;
- për ushqim të përforcuar, shumën prej 150 euro,
- për rehabilitim fizioterapeutik klimakterik, shumën prej 300 euro.

II. DETYROHET e paditura që në emër të kompensimit të dëmit material për veturën e shkatërruar të paditësit, t'ia paguaj paditësit shumën në lartësi prej 11.114,29 euro, respektivisht shumën e tërësishme të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial në lartësi prej **23.714,29** euro, të gjitha këto me kamatë sikurse për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar, e cila paguhet në bankat Komerciale të Kosovës, duke e llogaritur atë nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto brenda afatit 15 ditor nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë

III. DETYROHET e paditura KAG Asphalt Company që në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguaj paditësit shumën në lartësi prej 3.706,00 euro, brenda afatit 15 ditor pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

IV. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit D. H., mbi shumat e aprovuara sikurse në dispozitivin nën I dhe II të këtij aktgjykimi, e deri tek shuma e kërkuar prej 64.758,90 euro, **refuzohet si e pabazuar.**

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi përmes të autorizuarit të saj, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi për kompensimin e dëmit material dhe jo material, kundër të paditurës KAG-Asphalt Company, Sh.P.K K. e V., komuna e Prizrenit, duke theksuar se me datën 06.03.2009, në magjistralen Pejë - Prishtinë, më saktësisht në fshatin B., është shkaktuar aksidenti i komunikacionit, në të cilën dëm material në automjetin e tij të udhëtarëve Mercedes CI 500 pëson paditësi D. H.. Sipas padisë, deri te ky aksident ka ardhur ku paditësi D. H. me automjetin e tij “Mercedes CI 500”, me targa të regjistrimit *numri i targës...*, gjersa qarkullonte në drejtimin Pejë-Prishtinë, kur arrin në fshatin B., e godet pengesën në rrugë (kanali i hapur dhe makineria), të cilën pa kurrfarë shenje sinjalizuese e kishte lënë kryesi i punëve të rrugës, tani këtu e paditura KAG Asphalt Company, Sh.P.K K. e V. komuna e Prizrenit. Nga kjo goditje, dëm material në automjet, si dhe lëndime trupore pëson tani paditësi D. H., më gjerësisht sikurse në padi.

Edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor, i autorizuari i paditësit av.B. J. nga Prishtina, ka theksuar se mbetet pranë padisë dhe kërkesëpadisë së paditësit, duke e zgjeruar kërkesëpadinë e paditësit edhe për baza të tjera të kompensimit të dëmit, ndërsa në fjalën e tij të fundit në seancën e datës 25.08.2016, ka shtuar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së precizuar, të datës 26.07.2016. Sipas tij, gjatë procedurës së zhvilluar në këtë gjykatë pala paditëse konsideron të jetë vërtetuar plotësisht baza juridike e padisë dhe kërkesëpadisë së paditësit D. H. lidhur me aksidentin e komunikacionit të datës 06.09.2009. Në këtë kuptim gjithashtu pala paditëse ka konsideruar se raporti policor me skicën e vendit të ngjarjes si dhe ekspertiza e komunikacionit të ekspertit E. Q., e datës 09.12.2015, në mënyrë të mjaftueshme dhe besueshme e kanë faktikuar përgjegjësinë e të paditurës KAG Asphalt Company, për aksidentin e shkaktuar dhe pasojat e tij. Siç është bërë e ditur gjatë gjithë procedurës në këtë aksident paditësi pëson dëm të konsiderueshëm material dhe jo material, me rrezikim për jetën dhe shëndetin e tij. Mjeti i punës i cilësuar si shkaktar i aksidentit tip “Lamer 912” (i tipit bager) pa targa të regjistrimit ka qenë në pronësi të palës së paditur. Në të njëjtën kohë ky mjet, në kuptim të dispozitave të LMD-së, neni 154 dhe 155 paraqet send të rrezikshëm për të cilin konsiderohet se po qe se provohet kjo, është i obliguar që dëmin e shkaktuar ta kompenzoj, ashtu që i ka propozuar gjykatës që mbi këtë bazë të aprovoj një shumë të dëmit në vlerë aproksimative, sipas bindjes së lirë të gjykatës për shkallën e rrezikut mbi bazë të ekspertizave dhe bindjes së gjykatës, në shumën prej 20.000 euro. Ka shtuar se precizimi i kërkesëpadisë ka rezultuar mbi bazë të ekspertizës teknike – të makinerisë dhe lidhur me këtë në emër të dëmit material në tekstin e precizimit janë dhënë shumat përkatëse për të cilat konsideroj që janë plotësisht të arsyeshme duke qenë se mbështeten në konstatimet e bëra nga dy ekspertizat teknike - makinerike të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Ndërsa sa i përket dëmit jo material, ka shtuar se propozimet janë bërë mbi bazë të ekspertizës mjeksore nga lëmia e psikiatrisë dhe ortopedisë-traumatologjisë, të cilat gjetje dhe konstatime kanë rezultuar në bazë të egzaminimit të drejtëpërdrejtë të mjekëve në prezencën e palës paditëse si dhe në bazë të konsultimit të dokumentacionit mjekësor

në shkresat e lëndës duke filluar nga raporti i emergjencës e deri tek raportet e tjera specialistike të cilat gjithashtu janë vlerësuar nga mjekët. Përfundimisht ka propozuar që padia dhe kërkesëpafia e precizuar e paditësit D. H. të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe ligjshme duke e korigjuar shumën e tërësishme të shpenzimeve procedurale edhe në seancën e sotme gjyqësore në shumën prej 270 euro, ndërsa shumën totale të kërkesës së padisë i ka propozuar gjykatës që ta rrisë edhe për 20.000 euro, konform me dispozitat që përmbahen në nenet 154 dhe 155 të LMD-së, përkatësisht tek baza e kompensimit të dëmit jo material, më gjerësisht sikurse në procesverbalin e datës 25.08.2016.

E paditura KAG Asphalt Company, Sh.P.K. K. e V., Komuna e Prizrenit, ka parashtruar përgjigje me shkrim në padi përmes së cilës ka konstatuar faktin që vlera e shkaktuar siç kërkohet nga ana e paditësit është një shumë e madhe dhe është në disproporcion me dëmin e shkaktuar, duke e kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor, të autorizuarit e të paditurës e kanë kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit duke i propozuar gjykatës që të njëjtën ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Në fjalën e tij të fundit në këtë çështje kontestimore, i autorizuari i të paditurës av.R. H. nga Prizreni, ka theksuar se mbetet në tërësi pranë deklarimeve të dhëna në seancat e mbajtura, njëherit duke i propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pa bazuar, ngase sipas tij në këtë çështje kontestimore gjykata nuk ka asnjë vendim se për aksidentin në fjalë të komunikacionit, dikush të jetë shpallur fajtorë, prandaj edhe ka propozuar sikurse u cek më lartë. Ka shtuar se në qoftëse gjykata konsideron se egzistojnë elementet e fajit nga ana e të paditurit atëherë faji është i dyanshëm sepse as në raportin e policisë e as në ekspertizën e komunikacionit nuk është vërtetura shpejtësia e lëvizjes së automjetit i cili ka hasur kinse në pengesë në bagerin i cili kërkon statik dhe me të cilin janë zhvilluar punimet në aksin rrugor Pejë-Prishtinë. Në vendin kur ka ndodhur aksidenti shpejtësia ka qenë e kufizuar 40 km në orë dhe po të kishte vozitur paditësi me këtë shpejtësi 40 km në orë, me siguri aksidenti në këtë mënyrë nuk kishte me ardhë. Në lidhje me elementet të cila i ka paraqit paditësi si dëme jo materiale ka konsideruar se ato janë jo reale dhe nuk korrespondojnë me mendimin e mjekut të mjekësisë mjekoligjore i cili e ka bërë ekzaminimin e drejtpërdrejtë ndaj paditësit D. H.. Shuma për dhimbje fizike në shumën prej 14.000 euro, nuk është në përputhje me mendimin e mjekut dhe asnjë shumë tjetër nuk është adekuate me ato që ka konstatuar mjeku dr.A. T.. Sipas stij, as mjeku i neuropsikiatrisë nuk ka dhënë ndonjë element të saktë në lidhje me frikën, por ai e ka konstatu se egziston një frikë kohore. Andaj mbi bazën e të lartcekurave, përfundimisht ka propozuar që padia dhe kërkesëpafia e paditësit të refuzohet si e pabazuar apo që eventualisht të kostatohet se në këtë rast kemi të bëjmë me përgjegjësinë e ndarë të palëve ndërgjyqësore, më gjerësisht sikurse në procesverbalin e datës 25.08.2016.

Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: raporti i policisë për aksidentin me nr.09-AR-00523, i datës 06.03.2009, bashkë me skicën përcjellëse nga vendi i ngjarjes; dokument regjistrimi për automjete me nr. VRD 0879356; procesverbali mbi dëmtimin e automjetit, i datës 21.04.2009; ekspertiza e eksperit të komunikacionit E. Q. e datës 09.12.2015; raporti i qendrës emergjente të QKUK-së Prishtinë, të datës 07.03.2009 bashkë me konstatimin radiologjik, si dhe

raportet e qendrës spitalore të datës 12.03.2009 dhe 17.03.2009; ekspertiza e ekspertit I. G. mbi dëmet materiale të shkaktuara në komunikacion, e datës 29.02.2016; ekspertiza e ekspertit të komunikacionit R. Sh. mbi vlerësimin e dëmit në automjet, e datës 23.03.2016; është dëgjuar eksperti i psikiatrisë dr.N. F., si dhe është dëgjuar edhe eksperti mjeko-ligjor i ortopedisë-traumatologjisë dr.A. T..

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit është **pjesërisht e bazuar**.

Në bazë të raportit të aksidentit të policisë me nr. 09-AR-00523, të datës 06.03.2009, gjykata e ka provuar faktin se me datë 06.03.2009, në magjistralen Pejë-Prishtinë, gjegjësisht në fshatin B., është shkaktuar aksidenti i komunikacionit ku tani paditësi D. H. me automjetin e tij “Mercedes CI 500”, me targa të regjistrimit *numri i targës...*, e godet pengesën në rrugë (kanali i hapur dhe makineria), të cilën pa kurrfarë shenje sinjalizuese e kishte lënë kryesi i punëve të rrugës, tani e paditura KAG Asphalt Company, Sh.P.K. K. e V. – komuna e Prizrenit, ku si pasojë e kësaj goditje ai pëson dëm material, më gjerësisht sikurse në këtë raport.

Në bazë të dokument regjistrimi për automjete me nr. VRD 0879356, gjykata e ka provuar faktin se makina me të cilin është shkaktuar aksidenti, ka qenë pronë e paditësit, dhe se e njëjta në momentin e shkarkimit të aksidentit ka pasur regjistrim valid, më gjerësisht sikurse në këtë dokument të regjistrimit.

Në bazë të procesverbalit mbi dëmtimin e automjetit të datës 21.04.2009, gjykata e ka provuar faktin se automjeti i paditësit me të cilin ka pësuar aksident ka pësuar dëmtim serioz, ku pjesët e dëmtuara të të cilit janë të specifikuar, më gjerësisht sikurse në këtë proces verbal.

Në bazë të mendimit të ekspertit të komunikacionit E. Q., të datës 09.12.2015, gjykata ka konstatuar se sipas këtij eksperti rezulton se shkaku i aksidentit është se L. E., ngasësi i mjetit të punës “Liebher 912”, pronë e të paditurës KAG Asphalt Company, e ndal mjetin e punës në rrugë duke mos e siguruar me shenja përkatëse në rrugë, dhe shkaku i aksidentit është veprimi i tillë i ngasësit të mjetit të punës “Libher 912”, L. E., pronë e të paditurës, më gjerësisht sikurse në këtë mendim.

Në bazë të raportit qendrës emergjente të QKUK-së Prishtinë, të datës 07.03.2009 bashkë me konstatimin radiologjik gjykata ka konstatuar se paditësi D. H. si pasojë e aksidentit të datës 06.03.2009, ka pësuar lëndime trupore me gjerësisht sikurse në këtë raport.

Në bazë të raporteve të qendrës spitalore të datës 12.03.2009 dhe 17.03.2009, gjykata ka konstatuar se paditësi D. H. si pasojë e aksidentit në fjalë ka pësuar lëndime trupore më gjerësisht sikurse në këto raporte.

Në bazë të ekspertizës mbi dëmet materiale të shkaktuara në komunikacion, të ekspertit I. G. të datës 29.02.2016, gjykata ka konstatuar se duke pasur në konsideratë se automjeti ka qenë 9 vite i vjetër nga regjistrimi i parë, është reale dhe më ekonomike që të pranohet llogaritja e dëmit për riparim ku për sanimin e të njëjtit të pranohen qmimet e pjesëve të përdorura, pasi që vlera e dëmit përfshihet në kufijtë e vlerës reale të tregut për të njëjtin automobil, ku në këtë mënyrë respektohet edhe ekonomizimi i vlerës së dëmit. Përfundimisht vlera e dëmit në automjete të shkaktuar ditën e aksidentit sipas tij është 8133,53 euro, më gjerësisht sikurse në këtë ekspertizë.

Meqenëse ndaj ekspertizës së lartcekur ka pasur vërejtje nga ana e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, me ç'rast edhe është propozuar ekspertizë tjetër, gjykata e ka angazhuar edhe ekspertin tjetër për vlerësimin e dëmit material në veturën e paditësit, përkatësisht ekspertin e makinerisë ing.R. Sh. nga Prizreni.

Në bazë të ekspertizës mbi vlerësimin e dëmit në automjet të ekspertit ing.R. Sh., të datës 23.03.2016, gjykata ka konstatuar se riparimi i automjetit të paditësit si pasojë e aksidentit të datës 06.03.2009, nuk është ekonomikisht i arsyeshëm, pasi që vlera e riparimit e tejkalon çmimin real të tij në ditën e aksidentit. Kësisoj ka konstatuar se kompenzimi i dëmit duhet bërë në bazë të vlerësimit total të automjetit dhe atë në shumën prej 11.114,29 euro. I njëjti ekspert duke ju përgjigjur vërejtjeve të të autorizuarit të paditësit në seancën e datës 28.04.2016, ka sqaruar se përllogaritja e pjesëve në automjetin e caktuar është bërë në bazë të amortizimit të tyre sipas pjesëve kur ndodhen ato në automjet, sepse edhe amortizimi i pjesës, varësisht prej funksionit të saj, është i ndryshëm, prandaj çmimet e pjesëve janë adaptuar në ditën e aksidentit dhe vitit të prodhimit të automjetit, gjë që të gjitha janë marrë nga programi EURO TAKS GLLAS, që është një program softverik i programuar në tërë Evropën dhe mbi bazën e të cilit edhe bëhen përllogaritjet e tilla. Llogaritja e çmimeve është bërë në bazë të çmimeve të reja të pjesëve fabrikore të automjeteve përkatëse duke marrur parasysh edhe amortizimin e tyre i cili pastaj është zbritur nga çmimi i pjesës. Mirëpo çmimi përfundimtar nuk është marrur në bazë të riparimit, por është marrë në bazë të dëmit total, sepse riparimi i automjetit me dëmin që ka pësuar, kushton më shtrenjtë se sa vetë automjeti, prandaj automjeti në këtë rast është konsideruar teknikisht dhe ekonomikisht i pa arsyeshëm për riparim. Prandaj llogaritja e këtij dëmi është bërë në bazë të dëmit total dhe çmimi i automjetit në ditën e aksidentit sipas llogaritjes së ekspertit në fjalë, gjithnjë duke u bazuar në katalogun “ SchwackeListe”, dhe çmimit të automjetit në ditën e aksidentit, sipas ekspertit në fjalë ka kushtuar 15.225.00 cent. Nga ky çmim janë zbritur pjesët e pa dëmtuara të automjetit të aksidentuar të paditësit të cilat mund të shiten e që kapin vlerën diku rreth 4110 euro, e që del vlera për kompensim e cekur si më lartë prej 11.114,29 euro. Tutje, i njëjti ekspert ka sqaruar se me rastin e përllogaritjes së dëmit në veturën e dëmtuar merren për bazë shënimet bazë sipas librezës së qarkullimit, fotografitë e automjetit të dëmtuar në color (ngjyrë), ku shifen qartë pjesët e dëmtuara si dhe në programin e EURO TAKS GLLAS, ku shihen të gjitha pjesët e automjetit të caktuar, më gjerësisht sikurse në procesverbalin e datës 28.04.2016.

Propozim për superkespertizë nuk ka pasur nga asnjëra palë.

Në bazë të dëgjimit i ekspertit të Psikiatrisë dr.N. F., gjykata ka konstatuar se paditësi D. H., në aksidentin e komunikacionit të datës 06.03.2009, përpos lëndimve trupore, ka përjetuar edhe frikë. Ka shtuar se lidhur me frikën primare nuk mund të konstatohet prezenca e saj për shkak se paditësi ka përjetuar humbje të vetëdijës në

momentin e aksidentit. Ka përjetuar frikë sekondare të intenzitetit të lartë, e cila ka zgjatur rrethë 24 orë e manifestuar në formë të ankthit dhe pasigurisë nga mundësia e përfundimit fatal për vetën për çka edhe në emergjencë është trajtuar edhe me substanca qetësuese. Ka përjetuar frikë sekondare të intenzitetit të mesëm e cila ka zgjatur rrethë 1 muaj e shprehur në formë të nervozes së shtuar, shqetësimeve lidhur me pasojat nga aksidenti, dhimbjeve të kohëpaskohshme për çka ka kërkuar edhe ndihmë psikiatrike dhe i janë dhënë për përdorim barna qetësuese dhe antidepresive. Mund të konstatoj prezencën e frikës sekondare të ulët e cila ka zgjatur rrethë një viti e manifestuar në formë të stresit të tepruar, nervozes, kujtimeve traumatike nga aksidenti si dhe ngacmueshmërisë prej dhimbjeve të kohëpaskohshme, më gjerësisht sikurse në procesverbalin e datës 02.06.2016.

Nga dëgjimi edhe i ekspertit mjeko-ligjor i ortopedisë – traumatologjisë dr. A. T., gjykata ka konstatuar se paditësi D. H. ka pësuar lëndime trupore si: ndrydhje të kokës, ndrydhje-përdredhje të regjionit të qafës, thyerje të kockës së hundës, ndrydhje të regjionit të poshtëm të shpinës, ndrydhje të gjurit të majtë. Thyerja e hundës kualifikohet si lëndim i rëndë trupor. Sipas tij, në momentin e pësimit të aksidentit janë shkaktuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë të cilat kanë zgjatur për rreth 20 minuta deri në fillim të ofrimit të ndihmës profesionale mjekësore. Dhembjet fizike të intensitetit të rëndë të cilat kanë zgjatur për dy ditë ose (48 orë), kohë pas kohe deri në veprimin e terapisë të caktuar nga ekspertë mjekësorë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm të cilat kanë zgjatur për 15 ditë, dhimbja e regjionit të qafës, kokës, shpinës, gjurit të majtë dhe hundës e cila edhe është tentuar të vendoset në pozitën anatomike, dhimbje fizike të intensitetit të ulët të cilat kanë zgjatur për rreth 3 muaj, dhimbje që ndërlihen me aksidentin, dhimbje gjatë qëndrimit më të gjatë në këmbë dhe sforcimeve fizike me duar, në bazë të dhënave anamnesticke të paditësit. Shëmtim trupor ekziston në shkallë të ulët për shkak të devijimit të hundës me gjithë piramidën në anën e majtë të fytyrës e cila vazhdimisht është ekspozuar. Zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm i jetës ekziston në shkallë prej 5%, bazuar në tabelën për përcaktimin e zvogëlimit të aftësisë jetësore kapitulli V, pika 44 nën a, sipas autorëve S.M. dhe F.B., dhe ky zvogëlim manifestohet me ndryshim të piramidës së hundës e cila është e përcjellur me frymarrje lehtë të vështirësuar dhe që është verifikuar edhe me ekzaminime klinike dhe radiologjike. Kjo përcillet në mënyrë indirekte edhe me zvogëlim në shkallë të lehtë të kapacitetit vital të mushkërive. Ndihma dhe përkujdesi i personit të tretë ka qenë i nevojshëm në periudhën prej 7 ditë për të kryer disa aktivitete të përditshme jetësore, ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm në periudhën prej 15 ditësh i pasur me albumina, minerale dhe vitamina. Rehabilitimi klimaterik ka qenë i nevojshëm 2 herë nga 7 ditë, me qëllim të rikthimit të amplitudës së lëvizjes së qafës, sforcimit të muskujve të regjionit të qafës si pasojë e lëndimit të aparatit ligamentar dhe mbajtjes së detyruar të i mobilizimit, më gjerësisht sikurse në procesverbalin e datës 25.07.2016.

Baza ligjore

Me nenin 154 al.1 të Ligjit mbi Marëdhëniet e Detyrimeve (LMD) të zbatueshme për këtë rast, është paraparë se ***“kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftëse nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”***. Me nenin 174 të të njëjtit ligj parashihet se ***“për dëmin nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi i saj, kurse për dëmin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret me të”***, ndërsa me nenin 178 të po këtij ligji është paraparë se ***“në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar për faj të një poseduesi të automjetit, vihen***

në zbatim rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë”. Me nenin 195 par.1 të të njëjtit ligj parashihet se *“Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë,...”*. Sipas nenit 14 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është paraparë se *“në procedurën kontestimore gjykata më pikpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor”*. Sipas nenit 323 të LPK-së, është paraparë se *“po qëse vërtetohet se palës i takon e drejta që t’i shpërblehet dëmi në të holla apo me sende të zëvendësueshme, por pa mundësi që të caktohet shuma e të hollave, apo sasia e sendeve të tilla, apo se një gjë e tillë do të mund të bëhej me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendos sipas çmuarjes së lirë të saj”*.

Me nenin 7.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) është paraparë se *“palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*.

Vlerësimi përfundimtarë i gjykatës

Në bazë të lartëcekurave gjykata e ka vërtetuar faktin se e paditura është përgjegjëse ndaj këtu paditësit konform përgjegjësisë në bazë të fajësisë, të parashikuar me dispozitat e lartcituara të nenit 178 al.1 të LMD-së dhe dispozitave mbi kompensimin e dëmit konform shkallës së përgjegjësisë së tyre për dëmin material të shkaktuar, e të parapara me dispozitat e nenit 189 al.2 të LMD-së, si dhe dëmit jomaterial konform nenit 200 të LMD-së, e lidhur me nenin 174 të LMD-së, si dhe nenit 323 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK). Në lidhje me kërkesat e aprovuara në shumat sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata është e mendimit se të njëjtat janë adekuate, e krejt kjo duke marr parasysh dëmin material dhe jo material që i është shkaktuar paditësit.

Në lidhje me kërkesat e aprovuara në shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për paditësin, gjykata është e mendimit se të njëjtat janë adekuate, e krejt kjo duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësit dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t’i mundësoj të dëmtuarit – këtu paditësit, satisfaksion, që ai të jetë në gjendje që deri në një masë, t’i kompenzoj të mirat jomateriale nga të cilat është privuar, respektivisht atë shkallë të satisfaksionit të cilën ai do ta kishte po qëse të njëjtat nuk do t’i kishte humbur, e krejt kjo duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të shkaktuara, intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre dhe kohën e nevojshme të shërimit, nevojat e shtuara të ushqimit dhe mbi të gjitha zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën prej 5 %, respektivisht pasojat e lëndimeve më afër të përshkruara si në mendimet e ekspertëve të lartcekur. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial, si dhe në lidhje me shumën kompensimit të këtij dëmi, mes tjerash, gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cili i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe faktin që me të njëjtin, të mos u shkoj përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e këtij kompensimi dhe qëllimin e tij shoqëror. Mbi bazën e të lartëcekurave dhe në bazë të bindjes së saj të lirë e të formuar mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar në këtë procedurë, gjykata vlerësoi se kërkespadia e paditësit të parë është pjesërisht e bazuar dhe se e njëjta duhet të aprovohet në lartësinë sikurse në dispozitivin I të këtij aktgjykimi.

Gjykata e aprovoi edhe pjesën e kërkespadi së paditësit, e cila ka të bëjë me kompensimin e dëmit material për shkak të dëmtimit total të veturës “Mercedes CL 500”, me targë të regjistrimit *numri i targës...*, të cilën në momentin e shkakimit të aksidentit ka qenë duke e drejtuar paditësi dhe atë në shumën sikurse në dispozitivin II të këtij aktgjykimi, për arsye të cekura dhe të elaboruara sikurse më lartë. Kjo ngase në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar në këtë procedurë, përkatësisht ekspertizës së ekspertit të komunikacionit E. Q., është provuar se shkak i aksidentit është se L. E., ngasësi i mjetit të punës “Liebher 912”, pronë e të paditurës KAG Asphalt Company, e kishte ndal mjetin e punës në rrugë duke mos e siguruar me shenja përkatëse në rrugë. Ekspertizës së fjalë të komunikacionit gjykata i’a fali besimin e plotë. Vlera e veturës është përcaktuar në bazë të ekspertizës së ekspertit të makinerisë ing.R. Sh., të cilës gjykata gjithashtu i’a fali besimin e plotë.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese të kërkespadi së paditësit, respektivisht shumës mbi shumat e aprovuara sikurse në dispozitivin I dhe II të këtij aktgjykimi, e deri te shumat e kërkuar në lartësi prej 64.758,90 euro për dhimbjet fizike, për frikë, për dhimbje shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, për shëmtim dhe për ushqim të përforcuar, del se kjo pjesë e kërkespadi së paditësit, është e pabazuar. Mbi bazën e të lartcekurave, gjykata vlerëson se shumat e kërkuara për këtë pjesë të kërkespadi së paditësit, përtej shumave të aprovuara, nuk janë reale dhe se të njëjtat nuk i përgjigjen gjendjes faktike të vërtetuar, për çka edhe kjo pjesë e shumës së kërkuar me kërkespadi, u deshtë të refuzohet si e pabazuar. Gjykata po ashtu e refuzoi edhe pjesën e kërkespadi së paditësit të paraqitur në fjalën e tij përfundimtare në seancën e datës 25.08.2016, ngase i autorizuari i paditësit, përpos që e ka shtuar vlerën e kërkespadi së tij në shumën prej 20.000 euro, me asnjë provë nuk e ka arsyetuar e as argumentuar këtë pjesë të kërkesës së paditësit. Gjykata nuk pranon dhe nuk mund të aprovoj kërkesa bllanko të palëve. Gjykata në asnjë mënyrë nuk e përjashton mundësinë që paditësi të ketë krijuar shpenzime të caktuara përgjatë shërimit të tij, e as mundësinë që i njëjti të ketë pësuar fitim të humbur si pasojë e aksidentit në fjalë, megjithatë për këto shpenzime, nuk ka pasur as zgjerim të bazës së kërkespadi e as kërkesë për dëmshpërblim. E në pajtim me nenin dispozitat e LPK-së, përkatësisht nenit 7.1 të LPK-së, gjykata nuk ka tagër që *ex officio* të zgjeroj kërkespadinë apo të administroj prova, sepse *“palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet dhe provat e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrur konformë nenit 452.4 të LPK-së dhe atë për shpenzimet si në vijim: për përpilimin e padisë dhe precizimin e saj 186 euro; për 11 përfaqësime në seancë, secila prej tyre e llogaritur nga 270 euro; për ekspertizat mjekësore, ato të makinerisë, si dhe atë të komunikacionit shumën në lartësi prej 550 euro, respektivisht shumën e tërësishme të shpenzimeve procedurale në lartësi prej 3706 euro.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.630/15, datë 25.08.2016

Procesmbajtësja,
Drita Qerreti

Gjyqtari,
Valon Totaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.